



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 1548 prot.

Tiranë, më 14.02 2018

U D H Ë Z I M

Nr. 3, datë 14.02 2018

PËR
ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE
TË MATURËS SHTETËRORE 2019

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51, të Ligjit Nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

1. Lëndët e provimeve të Maturës Shtetërore 2019 për shkollat e arsimit të mesëm të lartë të jenë:
 - a. Provime të detyruara: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë dhe Gjuhë e huaj.
 - b. Një provim me zgjedhje.
 - 1.1 Testi i gjuhës së huaj (D3) hartohet në përputhje me gjuhën e cila në planin mësimor të arsimit të mesëm të lartë trajtohet si gjuhë e huaj e parë. Testi i provimit të jetë në nivelin gjuhësor që përcaktohet në kurrikul në përfundim të arsimit të mesëm të lartë.
 - 1.2 Gjuha e huaj, si provim i detyruar, përzgjidhet gjatë plotësimit të formularit A1/A1Z. Kandidatët e viteve të kaluara (të maturave shtetërore 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018), që kanë rezultuar jokalues në provimin D3, duhet ta rijapin këtë provim. Kandidatët e tjerë, (të maturave shtetërore para vitit 2014) që aplikojnë me A1Z, nuk do ta japin provimin e detyruar D3.
2. Provimi me zgjedhje
 - 2.1 Lista e lëndëve të provimit me zgjedhje të jetë:

Nr	SHKOLLAT E ARSIMIT TË MESËM TË LARTË
	Lënda
1	Kimi
2	Fizikë
3	Biologji
4	Histori
5	Gjeografi
6	Qytetari dhe Psikologji
7	Filozofi dhe Sociologji
8	Ekonomi

- 2.2 Provimet e detyruara të mbështeten vetëm në kurrikulën bërthamë. Programet orientuese të provimeve të detyruara (Gjuhë shqipe dhe letërsi, Matematikë, Gjuhë e huaj e parë) për të gjithë maturantët/kandidatët të jenë në përshtatje me programet ekzistuese të arsimit të mesëm të lartë.
- 2.3 Programet orientuese të lëndëve me zgjedhje janë të njëjta për të gjithë maturantët/kandidatët që plotësojnë formularin A1/A1Z.
- 2.4 Programi orientues i lëndëve me zgjedhje përmban programin e lëndës bërthamë dhe atë me zgjedhje.
- 2.5 Maturanti/kandidati zgjedh një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje, pavarësisht nëse e ka zhvilluar ose jo, apo i është ofruar ose jo ajo lëndë nga shkolla.
3. Kandidatit, që ka dhënë dy ose më shumë provime me zgjedhje dhe është vlerësuar me notë të përshkallëzuar jo më të vogël se 4.50 (nota 5), i njihen ato provime dhe nuk mund t'i japë më.
4. Kandidati, i cili rezulton mbetës në të paktën njërin prej provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore, duhet ta rijapë atë që të pajiset me diplomë.
5. Kandidatët, që në maturat shtetërore 2013-2018 kanë zgjedhur për të dhënë 2 (dy) provime me zgjedhje dhe:
- kanë mbetur në të dy provimet, të japin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij Udhëzimi;
 - rezultojnë kalues në një prej tyre, të pajisen me diplomën e maturës.
6. Kandidatët, që në Maturën Shtetërore 2012 kanë zgjedhur për të dhënë 3 (tri) provime me zgjedhje dhe:
- kanë mbetur në dy ose në tri provime, të japin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij Udhëzimi;
 - rezultojnë kalues në dy prej tyre, të pajisen me diplomën e maturës.
7. Kandidatët, të cilët kanë marrë dëftesë pjekurie para vitit 2011 dhe dëshirojnë të aplikojnë për

studime në institucionet e arsimit të lartë, t'u njihen provimet e detyruara dhe me zgjedhje ose provimet e njëvleftshme me to, të njehsuara nga njësitë arsimore vendore. Këta kandidatë, në rastet kur nuk kanë dhënë provime me zgjedhje ose i kanë dhënë dhe nuk kanë rezultuar kalues, kanë të drejtë të japin një provim me zgjedhje kur e kanë të nevojshme për plotësimin e kritereve të pranimit të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm i MASR-së, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe njësitë arsimore vendore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

MINISTËR

Lindita Nikolla

